

Tiranë, më 14.6.2022

Njoftim për shtyp

Komisioneri Publik ishte sot i pranishëm në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ku vijoi shqyrtimi gjyqësor i ankimit kundër vendimit nr. 241, datë 26.2.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Irena Gjoka, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, sot Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Kolegji i Posaçëm i Apelit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, vendosi:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 241, datë 26.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Irena Gjoka.

Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall, sot në Tiranë, më datë 14.6.2022.

Mbështetur në pikën 1, të nenit 16, të rregullores së Institucionit të Komisionerëve Publikë, ankimi dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni: <http://ikp.al/ankime/>

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.